

Luan
Qafëzezi

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1

216

Internationale
Botanische Reihe

poemë

864-1
216.

**Luan
Qafëzezi**

30 26 P



**INTERNACIONALE,
BOT A JONË E RE
poemë**

SHTËPIA BOTUËSE
«NAIM FRASHËRI»

**Redaktor
RAMAZAN VOZGA**

PROLOG

Tradhti!

Në qdo gjuhë të të përkthej

Ti mbetesh

E njëjta gjë:

Që nga Judët e hershëm

E gjer te passardhësit e Kautskit,

Bernshtajnit,

Brauderit,

Konfucit, — Një!

Po. Një!

Dhe kurrë, kurrë s'ke për t'u bërë dy!

Tradhti e «socializmit specifik»,

Që para Informbyrosë ne jemi ndeshur me ty,

Me emisarët e tu të paskrupull:

Vukmanoviçët e Rankoviçët xhelatë! —

Si qëllimet e tua të errëta,

Shpirti i tyre natë!

Pavarësinë në trekëmbësh deshe të na vije,

Lirinë — në gjotinë, në sépatë!

Eh, Partia jonë e hallevë,

Sa herë ata, sa herë tinëzisht t'u sulën nëpër natë

E sa e sa herë ti vendin u tregove

N'atë duel të pabesë,
N'atë duel vitesh të gjatë!
Po edhe më vonë,
Në Bukuresht a të Moskës hon,
Kur hrushovizmi tinës,
Mes ngricës e suferinës
Komunizmit iu turr,
Sërishmi ti, PPSH,
Që stuhive nuk u qe stepur,
Nuk u qe trembur kurrë;
— Ndal! — atij i brite
E, maskën duke ia çjerrur asaj dite,
Marksin, Engelsin, Leninin, Stalinin
Ngrite edhe më lart flamur.

Dhe ashtu,
Syrin pishë,
Furtunave u qëndrove gjoksin hapur!
Dhe ashtu,
Në gojë të ujqve, hodhe valle!
Dhe ashtu,
E patundur, istikamit të Karl Marksit,
Gjer Bota të bëhet Internacionale,
Po nis ti sot me ta
Të tretin duel të furishëm,
Të tretën betejë të madhe!

KREU I PARË

1.

Kopje e asaj të hrušovianëve,
kjo notë sterr!¹⁾

Diell,
kjo letër e PPSH-së²⁾
që po më fton të ulem;

Në thellësi,
revoltën ndiej
tek dheun tonë merr!

O penë e shtrenjtë,
mbi ty,
i heshtur,
ja se ku përkulem,

Ti shoqja ime mbete,
vjetesh
ditë e net ngaherë!

1) Nota e 7 korrikut 1978, me anën e së cilës Qeveria Kinezë, duke shtrirë mosmarrëveshjet ideologjike edhe në marrëdhëniet shtetërore, i bëri të njojur Qeverisë sonë vendimin e saj antishqiptar për ndërprerjen e ndihmës ekonomike dhe ushtarake Shqipërisë... si dhe për tërheqjen nga Shqipëria të specialistëve kinezë që gjer në atë datë punonin këtu.

2) Letra e përgjigjes që PPSH dhe Qeveria e RPS të Shqipërisë i dhanë KQ të PKK dhe Qeverisë Kinezë më 29 korrik 1978.

Si dje në luftë, moj,

Atdheut

dhe këtë natë

**Ne do ta shkojmë bashkë në udhëtim,
Në net me yj a kohë plot shtrëngatë
Asgjë s'e ndali tonin fluturim.**

Kënduam ne për Diellin tonë në jetë
Kur ai shtigjesh ende ishjtë larg;
Aherë mbi ne karvan vozitnin retë
Ndërsa mbi dhe trekëmbsha ngriheshin varg.

Kënduam ne për birin që ta solli
Nëntorn' e Kuq, o mëmë. Shqipëri,
Për Atë trim që zot, Atdhe, të dolli,
Kur aq nevojë për trimat kishe ti.

U nisëm ne nga një shtëpirzë Tirane
Me zemrën zjarr e t'gjithë një ideal,
Me Të ne ballë i bëm' çdo tramundane,
Më Të mbi malet ne u ngritëm mal.

Vërtet dyqind, po një e të pandarë,
Dyqind rrëth Tij, po hekur e beton,
Ata për ne — aradha jonë e parë,
Ata për ne — i pari eskadron.

Shoku Enver, në krye grushtin ngritur,
Ne përmbas Tij nën qiellin pus të vrantë,
Rrugën ndër net Ai duke na ndritur,
Ai gjithmonë i urti Komandant.

Me Të, Parti, për ty ne edhe jetën
Nuk e kursyem kurrë në rrebesh,
Se vetëm Ti mbi tokë të vërtetën,
Përjetësish e zbrite midis nesh.

Sa thellë, o mëmë, rrënjet i ke shtrirë,
Sa rrëke gjaku derdhe për liri,
Sa monumente sipër dheut mbirë,
Si në legjenda, eh, sa histori!

Sa Vojo Kushër përmbi tanke hipur
E përmbi tanket ngritur lapidar,
E sa Perlatër zjarreve zhuritur,
Po përmbi zjarret vetë ata zjarr!

E pranë tyre Bulet, Persefonët,
Që në trekëmbësha shkallët ngjitkan qetë,
Sa Bilbilenjtë mahnitur i vështrojnë
E s'iu besokan dot syve të vet.

E që të gjitha majë nëpër shqotë,
Atdheut i qeshënët e mësuarat
Sikur ato, më t'lu maturat në botë
Përjetësisht të qen' në atë çast.

O shokë të shtrenjtë, heronj dhe heroina,
Ju një nga një të gjithve ju kujtoj,
E cilin mal e mposhti suferina,
E kush nga ju asaj nuk i qëndroi?

Armatë ju bëri ju revolucioni,
Për komunizmin flakë ky dhe u dogj,
Sa herë për të sulmuat buzë honi,
Sa herë vdekjen patë tek u tërhoq?

Nga ti, Parti, për t'bardhat dit' të reja,
U rrit këtu armatë Njeriu i Ri,
Ai që shkëmb u ngrit dje nér beteja
E pas Çlirimt shkëmb sërisht ai!

Ai që sulmin për ndërtim të vendit
Përmby gërmadhat nisi gjithë zjarr,
Që piramidash, filli majë shkëmbit,
Me gjak Atdheut ia mbroi dhe një fill bar.

Ai, ai, që me racion të pakët
E mori bukën vjete pa u ndier,
Ai që thau Maliqët e Thumanët
E ngricat kurrë, s'e ngrinë asnjëherë!

Ai q'lumenjve: — Ndal! — gjithmonë u briti
E gjoksin hapur vetë u bëri pritë,
Ai që varg liqene ngado ngriti
E dallgë e valë i qetë i ktheu në dritë.

Ai që çau tunele anembanë,
Ai që shina shtron nëpër Atdhe,
Ai që ty pérherë t'u gjet pranë,
Ai që oxhaqet shpie gjer në re!

Ai që dhe fushat i mbulon me grurë
E dheun tonë ngado me krenari,
Ai që jetë ngjall edhe mbi gurë
E përmbi sofrat gaz në çdo shtëpi.

Ai, o mëmë, që lindi nër luftime
E shtat lëshon çdo ditë në barrikada,
Ai që s'pyet e s'pyeti për rrëthime,
Ai që çau e çan përmbi bllokada;

Sepse, Parti, prin ti në t'zjarrtën udhë,
Sepse, Parti, ti mal në çdo tufan,
Se në ndërgjegje ti as dhe një rrudhë,
Se ti gjithnjë në t'Marksit istikam.

Dhe ashtu grusht, përballë çdo armiku,
Parti e popull ecim gjithnjë lart,
Ky unitet — kështjella prej çeliku,
Ky unitet — i yni kyç i artë.

KREU I DYTE

1.

Teoricienë të «tri botëve»,
Prapa dhe më prapa diellit,
Larg edhe më larg.
Në çdo bisedë e varg
Lumë na vërshon urrejtja ndaj tradhtisë suaj, —
Të zezë si kjo notë e juaj,
Si bota juaj,
Si pabesia juaj,
Si largimi juaj nga e vërteta — diell që ndrit e përflak,

Si afrimi juaj
Me reaksionin — Shtëpinë e Bardhë, batak,
Si thika juaj që revolucionit pas shpine i rri,
Si kurthi juaj.
Ngritur luftërave për liri,
Si ëndrra juaj për ekspansion,
Si ethja juaj për superfuqi.

2.

Eh, tradhti!
Tradhti revizionistësh,
Stisur skutash nëpër natë,
Si kjo notë e zezë kineze
Fytyra jote plot zhobra,
Rrugë jote e gjatë!

Por jo! Jo!

Arsyet e prishjes sonë nuk janë tetë «faktet»
E apologjetëve të tu dhelparakë:

Se një zëvendësministër yni gjaknxehtë u tregua
sadopak;

Se diku specialistët tanë s'u zgjuan me humor një
mëngjes;

Se diku, për fajin e tanëve,

S'u zbatua siç duhej një projekt «gjenial» kinez;

Se dikush nga tanët

S'i firmoi procesverbale të për vënien e një objekti
në jetë;

Se ambasadori shqiptar në Pekin

E refuzoi

Notën, tuaj

Të 7 qershorit 78...

Kjo farsë kineze

Zor e ka të mashtrojë edhe një njeri mendjelehtë.

Arsyeja?

Jo.

Nuk është kjo arsyeha e vërtetë.

Tjetër,

Tjetër është ajo, ajo që i ndau përjetë.

Dy brigjet e këtij deti në stuhi, —

Të komunizmit-flakë, nga të tutë-mjegull e bëatak,
tradhti!

KREU I TRETE.

1.

Të papritura! Sa të papritura në pak vite!
Aq sa proletarë e popuj pyesnin me habitje:
Si është e mundur,
Një parti që në emër të Marksit e Leninit flet,
Brenda një dekade — viteve gjashtëdhjetë,
Tri herë me radhë fytyrën e saj ta ndërrojë,³⁾
Tri herë me radhë ta ndryshojë boshtin politik të
vet?

2.

Pekin, 62:
Dy delegacione partie:⁴⁾ yni dhe juaji,
Përballë njëri-tjetrit të dy.

3) «Brenda 10 vjetëve, që nga viti 1962 deri në vitin 1972, tri herë me radhë ndryshoi boshti i politikës kineze».

(Nga letra e KQ të PPSH dhe e Qeverisë së RPS të Shqipërisë drejtuar KQ të PKK dhe Qeverisë Kineze më 29 korrik 1978).

4) Në takimin e delegacioneve të PPSH dhe PKK, në qersher të vitit 1962, në Pekin, Liu Shao Çia dhe Ten Hsiao Pini, duke theksuar se armiku kryesor ishin imperializmi

Për palën tuaj armiku kryesor — imperializmi amerikan —
Për ne të dy superfuqitë — ujk dhe ujkonjë, në një plan.

3.

Sipas jush:

«Socialimperializmi rus
Në frontin antiimperialist duhej përfshirë!
Për ne — i papranueshëm ai mendim,
I huaj,
I pështirë.

4.

Dhe ankthi rritet në sallë! Shqetësim në tryezë.
Ju ngulni këmbë në tuajën,

Po për ne:

Sërisht i papranueshëm ai mendim,
Sërisht e neveritshme ajo tezë.

amerikan dhe aleatët e tij, «shtruan me këmbëngulje pikë-pamjen e udhëheqjes kineze, sipas së cilës fronti antiimperialist duhej të përfshinte medoemos edhe Bashkimin Sovjetik ... që udhëhiqej nga klika revizioniste e Nikita Hru-shovit».

(Nga letra e KQ të PPSH dhe e Qeverisë së RPS të Shqipërisë drejtuar KQ të PKK dhe Qeverisë Kineze më 29 korrik 1978).

Dhe biseda merr horë.

Flet Partia e Punës e Shqipërisë, dëgjon Iliçi prorë:
— Pa luftën kundër të dy palëve në të njëjtën kohë,

Fitorja kurrë s'do t'i buzëqeshë proletariatit,
Gjakun do t'ia gërryejnë mbi tokë, breshër e llohë! —

Dhe anija lëkundet nga thellësitë deri në bord.
Kuvendi në dallgë: nxehet, bymehet si deti,

Ndërsa

Nga portreti,
Tradhtinë duke ndier Iliçi i pamort,
Vetullat ngrys dhe më fort,
E, n'atë ndeshje kuptimplotë,
Duket sikur PPSH-së i thotë:
— Vazhdo! Vazhdo! Vazhdo! Me ty unë jam dakord.

Dhe dueli vazhdon pa i lëshuar njëri-tjetrit
Asnjë milimetër.
«Bashkëluftëtarë»,
Po ku preken parimet —
Pole të kundërt të të njëjtit diametër.

5.

Dhe ashtu asaj here ftohtë u ndamë.
Po një ditë,
Thellësive të Semipalatinskut, Nevadës ku s'hyn dritë,

Për monopolin atomik,
Sundimin mbi botën e gjerë,
Ndalimin në atmosferë
Të provave bërthamore
Nënshkruan superfuqitë.⁵⁾

Ju dogji ajo sfidë,
Ju dogji ajo pritë.

E nditet, —

Një èndërr të lashtë⁶⁾ ai traktat donte t'ju venitë.
Atëherë,

E vetëm atëherë
Gjaku juaj «u ndez»,
Dhe «zjarr»,
«Zjarr» hapët,
«Polemikën filluat një mëngjes».

5) «... Nënshkrimi i Traktatit anglo-sovjeto-amerikan, në gusht 1963, për ndalimin e provave të armëve bërthamore në atmosferë, që pasqyronte bashkimin e përpjekjeve të dy superfuqive për vendosjen e sundimit të tyre mbi botën, e detyroi udhëheqjen kineze të fillonte polemikën e hapur me Hrushovin...»


(Nga letra e KQ të PPSH dhe Qeverisë së RPS të Shqipërisë drejtuar KQ të PKK dhe Qeverisë Kineze më 29 korrik 1978).

6) Èndrrën për t'u bërë superfuqi, èndrrën për t'u bërë një nga forcat më të mëdha bërthamore të botës.

Ne i dëgjuam goditjet që ranë mbi ta;
Ne u gëzuam si shokë armësh, llogoresh përkrah,⁷⁾
Po ju prapë flirtuat,
Prapë shpresuat tek ata!

7) «Kjo nuk mund të mos e gëzonte Partinë e Punës të Shqipërisë e popullin shqiptar, të cilët, të vetëm kishin gati tre vjet që po përballonin sulmet e hapta e të tërbuara të Hrushovit dhe të mbarë revizionizmit modern».

(Nga letra e KQ të PPSH dhe Qeverisë së RPS të Shqipërisë drejtuar KQ të PKK dhe Qeverisë Kineze më 29 korrik 1978).



KREU I KATERT

1.

Vjeshtë.

Tetor' 64.

Në Kremlin zjarre në vatër.

Rreth zjarreve një puç i ri:

Hrushovin pas krahësh varrozin dishepujt e tij.

Në sheshin «Tien-An-Men» — festë,

Në sallën e pritjeve — dolli:

Përshëndetje udhëheqjes së re sovjetike,

Përshëndetje Brezhnjevit në fuqi!

2.

Dhe rishmë mitingje e festë

Në sheshin e madh të Pekinit.

Flet Çui:

— Shokë! Dita që pritej agoi.

Dëgjojini, dëgjojini Orët e Kremlinit,

Ora e bashkimit të madh

Tingëlloi! —

3.

Dhe zien e zien sheshi «Tieh-An-Men»:
Det derdhen nëpër udhë punëtorët e fshatarët.
Për këtë «fitore» të komunizmit,
Marksizëm-leninizmit,
Qiellin
Me fjalën e Maos, Liut, Çujt,
Çajnë fishekzjarrët.

4.

Entuziazëm!
Brohoritjet arrijnë në stratosférë,
Byroja Politike në ëndërrim,
Pekini në gaz të paprerë!
Çu En Lai, për Revolucionin e Tetorit,
Këmbëngul,
Moskës,
Së bashku t'i shkojmë krahënderë...

Po PPSH-ja, që qartë e vren këtë humnërë,
S'ngurron, —
Prerë
Udhëheqjes kineze t'ia japë përgjigjen e saj:

«Shokë! Na çudit diktati i shokut Çu En Lai!
Na çudit vendimi juaj në Moskë pér të shkuar!
Ne e quajmë këtë hap
Të dëmshëm pér çështjen tonë të përbashkët,
Ne e quajmë këtë hap:

Të padrejtë,
Të gabuar.

Fundi i Hrushovit pér ne? —
Vetém një degëz dafine në këtë betejë
Të ashpër e të madhe.
Por ai ende nuk shënon
Triumfin tonë në histori,
Ende nuk dëshmon pér revizionizmin,
Shembjen e tij përfundimtarë.
Flamurët e tij ogurzez? — Kongreset Njëzet dhe
Pa përmbysjen e tyre, shokë, Njëzet e Dy.
Tradhtia s'lëviz që aty;
Ndaj,
Asnjë tërheqje,
Asnjë iluzion!
Nikita Hrushovi ra
Po hrushovizmi pa Hrushovin vazhdon».

Dhe Mao e Çu e muarën dhe këtë letër,
Po, si gjithnjë, si çdo herë tjetër,

S'u ndien gjëkund;
Po, si gjithnjë, si çdo herë tjetër,
Si renegatë e pragmatistë
 të regjur,
 të vjetër,
Drejt Moskës,
ethshëm vrullin,
 shpejtuam sa mund!

KREU I PESTË

1.

Mëngjes!

Pekin,

7 nëntor.

Grumbulli diplomatësh në aeroportin shtetëror.

Mbi pistën e qullur një avion në start.

Një delegacion partie e qeverie ngjitet lart.

Prin Çu En Lai,

Apostull i ujdice e i ujdisë.

Në njëren dorë lule për Brezhnjevin,

Në tjetërën mesazhin e miqësisë.

Përshëndetje delegacionit.

Brohoritje në aeroport.

Buçasin turbinat,

Gjëmojnë pilotazh e bord.

Mbi pistë lëvizje.

Supersoniku rrugën nis.

Prapa mbetet Kina.

Mjegull mbi hapësirat e Rusisë.

Në stepat e pafund tufan,

Në Vnukovo breshër,

Në Gjeorgjevska kallkan.

Vyshken tubëzat me lule të Pekinit,

Zverdhen fletët e mesazhit kinez,

I zhgënjer delegacioni,

Rrugën drejt Çin Ma Çinit
Merr një mëngjes.

U tretën ëndrrat e pajtimit si kripa në ujë,
U varrosën iluzionet që rënia e Hrushovit zgjoi,
Mori fund armëpushimi⁸⁾ që Çui në «Zhenmin-
zhibao»

Shpalli me aq bujë!
Kokulur,
Udhëheqja kineze
«Polemikën» detyrohet të rifillojë.

8) Posa ra Hrushovi, Çu En Lai shpalli me bujë ndër-prerjen e polemikës me revisionistët hruhovianë.

KREU I GJASHTË

1.

Uashington, '71!

Natë.

Një fantazmë, me emrin Kissinger,

Del nga kabinetin i presidentit,

Del nga «Shtëpia e Bardhë»!

Në aeroport një avion pret!

Fantazma hyn e zë vend shpejt.

Supersoniku ngrihet në shtrëngatë.

— Pilot, duhet të arrijmë para se të zbardhë!

Rrite, rrite shpejtësinë, pilot! —

Dhe turbinat uturijnë e angullijnë po si mort.

Fluturim mbi Pekin.

Supersoniku zbret.

Me lule Cui fantazmën pret në anonimin aeroport.

Cu e fantazmë,

Përmallshëm,

Duart shtrëngojnë fort.

Po koha s'pret, nuk pret pér më gjatë:

Veturat jashtë Pekinit duhet të çajnë nëpër natë...

Fantazmave drita sytë ua vret.

Si netët e dhjetorit të gjata ato takime,
Të ngrohta ato biseda,

Ato akorde e piketime pa fund!
Mbi Lindjen e Largët,
Mjegulla e përhime
Heshtazi nis të ngrihet,
Heshtazi nis të shtrihet
sa mund!

2.

Dhe ashtu, tinëz, tinëz,
Rrugën vazhdoi tradhtia nëpër mjegullën det,
Po dhe nëpër mjegull e net
S'preheshin fishat e agjencive telegrafike,
Uturima e tyre një ditë ngado oshëtiu nëpër planet:
«— Pekini në festë! Pekini së afërmi pret
Të parin president,
Të parin mik të madh prej Amerike!»

3.

I habitshëm ai lajm për ne!
Mao Ce Duni do të priste kryexhelatin e Vietnamit?!
Po PPSH-ja, që mbi dafina kurrë s'kishte fjetur as
fle,
Si gjithnjë e patundur prej istikamit,
Si gjithnjë pranë udhërrëfyesve, —
Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit,

S'ngurroi udhéheqjes kameleone tē Pekinit
Hapét t'ia shprehte çdo gërmë tē mendimit,
Hapét çdo gërmë tē protestës së saj, — rrufe!

4.

KREU I SHTATE

1.

Re!

Një re edhe më e errët

Qiellin kinez mbulon...

Po Perëndimi hareshëm zien, Lindja gjëmon!

Dhe gjëmime, gjëmime nga Jugu në Nord;

Një supersonik, një boing,

Nga Uashingtoni, mbi Pekin

Ulet në aeroport.

Kureshtar, kreu i kapitalit botëror, Niksoni,

Me pasardhësit e Mencit, Konfucit

Duart shtrëngon fort.

Nga gëzimi

Fluturojnë kaporionët Çu e Kissinger.

Fjalime ndoshta «s'ka», po mbi shtrojerëza lulesh

Vetura e mysafirit rrugën merr;

Rrugën nis që tej aeroportit

«I padukuri» trup diplomatik, —

Kina nga USA, sot,

Për të parën herë,

Pret më të shtrenjtin,

Pret më të madhin

mik!...

2.

Piketime e akorde dihet: me kohë e me kohë janë
arrirë!...
Sa e sa fluturime nga Uashingtoni në Pekin
E sa e sa të tjera nga Pekini në Uashington!
Dhe të gjitha, të gjitha, të gjitha në errësirë.

Tani firma e të dy presidentëve pritet,
Mbi to — një vulë e ngrirë.

3.

Kthesë.

180 gradëshe kjo kthesë monstruoze.
Për mikun e madh, në Çun Nan Hai⁹⁾ e në shtëpi
të Maos,
Pritje pompoze.
Për rindarjen e botës bisedohet kokë më kokë.
Tani e tutje: Kina dhe USA — shokë.

9) Vendi ku udhëheqja kineze priste mysafirët e saj të lartë.

KREU I TETË

1.

Përsëri në Pekin!
Kësaj here ne, — delegacion nga Shqipëria mike,
Folëm për takтикën e strategjinë,
Folëm për Shqipërinë
Që armë të rënda kërkonte,
Si avanpost i socializmit
Në prapavijat armike.

2.

I ngrysur na dëgjove, Çu, e «qeshe»,
I ngrysur na dëgjove, Çu, e the:
— Iluzion, miq e shokë! Iluzion i kotë!
Shqipërisë s'kanë ç'i duhen armët e rënda sot,
Shqipëria
Superfuqive
As edhe një ditë të vetme
Ballë
S'u bën dot —.
Dhe propozovë;

— Në rast sulmi nga të huaj,
Për ju, një zgjidhje mbetet me vlerë:
Shndërrimi në njësite e çeta i armatës suaj,
Braktisja e qyteteve,
Ngjitja në male menjëherë —.

Dhe prapë e prapë shtove në atë bisedë pus:

— Në këto momente,
Kur hegjemonizmi rus
Përgatitjet drejt Ballkanit s'po i resht,
Për Shqipërinë ka edhe një shteg për t'i shpëtuar
kësaj flake:
Bashkimi Tiranë, Beograd, Bukuresht,
Lidhja ngushtë me ta
Në një aleancë të gjatë e të fortë,
Në një aleancë të hekurt ushtarake —.

Po PPSH-ja
Si një lëvere të molepsur
Flakëve ta hodhi
Edhe këtë thirrje dinake.

3.

Të habitshme,
Të habitshme e kan' logjikën tradhtitë!
Deshe të na trembje, Çu,
Me sulmet nga jashtë,
Superfuqitë!
Po superfuqi ishin në kohë të tyre
Edhe Roma e Bizanti,
Superfuqi Turqia,
Po përballë superfuqive
Shtatin dhe emrin
Rriti Shqipëria.

I rritën shekujt këto troje të thepisura, të lashta
E rritën këtë popull ndeshjet pafund me ta...
Nga pirjet e varrezave të tyje
Majat ngriten këto male
Të ashpra, të vrazhdta,
Këto male e vargmale
Që qiejt plot yje
Mbajnë në krahi.
Dhe bota e di mirë.
Mirë e njeh historia.
N'atë kohë,
Kur në Ballkan
Kishin rënë flamurët e tjerë
E në dyert e Vjenës trokiste Osmanllia,
Mbi këto troje

Një flamur¹⁾ palët rrithë në erë.
Krenar dhe debojë.

Një flamur

Që

Me turp

Gjithsaherë i mbuloi
Muradët e Mahmudët,
Bajazidët e Ballabanët
Derbederë...

Një flamur

Që

Aleatëve të vet, kur patën nevojë,
Dhe mbi Jon e Adriatik kaloi
E në ndihmë u shkoi
Sa e sa herë!

E, po ashtu,
Kush mund të thotë
Se
Në ditët e veta
Fuqi të mëdha nuk qenë
Dhe Italia e Gjermania e Hitlerëve?
Po
Në këta male e vargmale, dervenë-dervenë,
Regjimente e divizione pre iu mbenë

1) Flamuri i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut

E kryet
Gjeneralë e shtatmadhorë
Ulën
Para maliherëve

4.

Shqipëri!
I vetmi vend në Evropë
Që me forcat e tua u çlirove,
Që me forcat e tua i solle ti ditët e ra!
Shqipëri!
I vetmi vend i vogël,
Që, si vëllezërve, dhe fqinjëve në ndihmë u shkove,
Kur dielli nuk dukej,
Kur dielli nuk ndriste mbi ta!

5.

Eh, Kosovë, Kosovë,
Me sa mall na prite!
Vëllezërit e një gjaku,
Përkrah luftëtarëve të tu, erdhën të të sillnin rreze
drite.
S'do t'ju harroj kurrë, Gjakovë e Prizren,
Pejë e Mitrovicë!
Dhe ty, Tuz e Podgoricë,
Deçan e Deçic,

Gjilan, Prishtinë, Rugovë, Drenicë!
Po dhe ju vise fqinjësh: Prieplje, Nikshiq, Zllaticë,
Suhagorë, Vishegrad, Sanxhak!
Sa gjak! Sa gjak!
Si shokë armësh,
Tanët,
Për krah vendasve
Ranë krah pér krah.
Sa nëna shamizeza edhe në ato vise fqinjësh
Me gjithë shpirt qanë mbi ta,
Mbi varret e tyre larg Shqipërisë:
(Po të ndritur, të madhërishëm, të qetë)
Ku gjakun falën e u shkrinë
Pér të mbetur
Simbol ndihme e sakrifice,
Simbol internacionalizmi proletar pérjetë.

6.

Jo,
Tradhti kralësh e Pashicësh,
Vojvodësh e Rankovicësh,
Mbi këtë gjak ti nuk shkel dot!
Popujt prej natyre
Janë miq midis tyre
E dëshirojnë:
Miq të mbeten jetë edhe mot.

7.

Mao e Çu,
E zezë èndrra juaj dje,
E zezë èndrra e Ten Hsiao Pinëve sot!
Por jo, Ballkanin kurrë s'keni pér ta mashtruar,
Ballkanin kurrë s'keni pér ta shndërruar
Në një fuçi barot.

Partia e Punës e Shqipërisë,
këtë,
me kohë jua ka thënë me gojën plot.

KREU I NËNTË

1.

Socialimperialistë!
Hrushovianë e maoistë!
Ju? —
E njëjta fytyrë,
E njëjta monedhë tregu e botës kapitaliste!
Polemika midis jush? — E huaj për Marksin dhe
Leninin mal.
Ajo? — Murtajë
Që sjell vetëm
Erëra, shtrëngata, pshtjellime ndërimperialiste;
Ajo? — Përleshje ujqish, tigrash, hegemonësh
kanibalë
Që njëri-tjetrit për sfera influence,
Ngastra,
Pushtime,
Janë gati
Lëkurën t'i zhvatin,
Gati
Ta hanë të gjallë!

2.

Ju? Të dy palët ju mohues të revolucionit,
Brumë i një mielli, bimë e një are,
Me rrënje të përbashkëta,
Ëndrra të njëjta, një ideologji.

Ju? —
Dishepuj judësh, klikash, skotash tradhtare,

Ju? —
Pjellë Bernshtajnësh,
Konfucësh,
Buharinësh
Në Kinë dhe Rusi!

3.

Ju, si njëra dhe tjetra palë,
Të paskrupull në synimet e qëllimet tuaja,
Të pangopur në lakmitë e gllabërimet tuaja!
Për ju: skuqja, verdhja, turpi, nderi, — të huaja!
Ju, në çdo arritje qëllimi, — Makiavelin mbani
pranë.

Dhe ashtu,
Ndërsa në njérën anë,
Me të,
Edhe djallit dorën i shtrëngoni
E thirrje popujve u bëni
Për bashkëpunim me imperializmin janki,
Në tjetrën, si ata në Far-Uest, të etur për flori, —
s'ngurroni,

Drejt kasafortave
Të Fordëve, Rrokfelerëve, Krupve të vraponi
Për ar,
Armë,
Kredi!
Dhe gjithmonë,
Gjithmonë ndaj tyre, ju:
Buzën në gaz e dorën shtritur.
Kurse ndaj aleatëve tuaj sa herë të pabindur,
Aq herë shkopin ngritur,
Aq herë grushtin hakërruar;
Budët nga aleatët kërkojnë «nënshtrim»!
Carët, «sovranitet të kufizuar»!

4.

Po. Si dy pikë uji ju njëri-tjetrit i gjasoni!
Ju dhe renegatët i rehabilituat
E në piedestal i ngritët,
Kurse mbi PPSH-në,
Që marksizëm-leninizmin
Mbron nga erozioni,
Si njëra dhe tjetra palë
S'mungoni
Mbi të, — me të gjitha armët të qëlloni!
Mbi të, — me të gjitha bateritë!

5.

Sipas jush, tani,
«S'është koha që revolucioni majat të ngjitetë (!)
Hapa të tillë një fund i mjerë kish pér t'i pritur!»
Ndaj,
Proletariatin
«Në biblioteka ftoni të mbylljet natë edhe ditë»
E atje,
«Me Maon në duar, Maon — dritë»,
Veten të përgatitë
Pér të ardhshmet beteja
«Të së nesërmes së tij të ndritur!»

Hipokritë!
Kjo është rruga që klasës i tregoni!
E ndërsa,
Në njërin krah,
Si njëra dhe tjetra palë, — s'ngurroni,
Hipur kalit,
Zérin të çoni pér luftëra ndërimperialiste,
Në tjetrin, — misionin e «harroni» të Partive
Komuniste

Që,
Si gjithnjë, në pararojë gati,
Midis buçitjeve, gjëmimeve që ziejnë,
Rrugën duhet të gjejnë
Pér t'ua ndërruar drejtimin këtyre luftrave
grabitqare

E në revolucionë proletare
T'i shndërrojë këto kasaphana,
Këto gjakderdhje,
proletariati.

6.

Por më kot!
Se ju lëmsh i keni bërë klasat,
Lëmsh ndarjen e tyre në botë!
Sipas jush, sot, asgjë s'i ndan,
Po gjithçka,
Gjithçka i bashkon proletariatin me borgjezinë.
Pra,
Ujku dhe qengji,
Duke mallkuar «të kaluarën e hidhur», — historinë..
Pranë e pranë mund të rrinë
E, pranë e pranë tani,
Mund të prehen,
Mund të flenë
Në një kthinë!

7.

Ju?
Gjer dje ju
Thirrje bënët:
«Popuj, kujdes!
Socialimperializmin, imperializmin, në shënjestë!

Ata luftën mund tē shpérthejnë një mëngjes». Kurse sot, me «kaubojtë» po puthi si miq, tē vjetër! E ndërsa
Me ata
Rindarjen e botës ëndërroni,
S'ngurroni,
Si dikur motit — Gebelsët, Geringët, Hitlerët,
Hipur majë sopit,
Zérin tē ngrini plot histeri:
«Vëllezër! Hegjemonizmin sovjetik në grykë tē topit!
USA-s aleate, paqëdashëse,
lavdi!»

8.

Dhe prapë,
Ishit ju që gjer dje:
«Plan strategjik gjenial» e quanit teorinë e «Tri
botëve»,
Forçë lëvizëse, që, mbi rruzull, asgjë nuk e ndal!
Po tani që për rindarjen e globit, shokë u bëtë
«të kaubojve»,
Ç'u bë e famshmjë «Botë e tretë» e juaja,
I Maos «Plan strategjik gjenial»?
E qartë — Ajo botë ish, mbeti dhe do të mbetet
vetëm në letër!
Ajo — mashtrim e bllof për proletariatin,
Mashtrim e bllof për popujt në masë;
Ajo — tramplin

Që Kinën drejt brigjeve të vjetër
Ta hidhte, siç e hodhi, — ta nxirrte, siç e nxori, —
Përkrah SHBA-së.

9.

Pa na u nise, sherifi Ten,
Na u nise,
Përmallshëm e ëndrra e ëndrra plot
Dhe bekimin
Nga krerët e jankive
More n'Amerikë.
Po duart, sherif,
Duart,
Ku, vallë, do të mund t'i futësh ti sot,
Kur ato,
Gjak vietnamezësh,
Nënash, fëmijësh,
Të pikojnë pikë-pikë?

10.

Tani pa maskë,
Krejt pa maskë,
Kur dhe pronat kapitalistëve ua ktheve me përunjësi,
Kur dhe uiski e narkotikët, sherif, s'të mungojnë,
Kur dhe rokendrollin miqtë po ta mësojnë me dashuri

11.

Po.
Ju që të gjithë:
Kusarë të një natyre, gangsterë të një treve
Në bashkëpunim dhe rivalitet të plotë.
Zjarret në Lindjen e Mesme janë pjellë e ju të
treve,

Dhe pjellë e juaj
Vratat e zjarrit
Që ndizen
Ngado nëpër botë.
Kështu,
Si shokë armësh,
Ju tani përqafohi me Karterin,
Mobuton,
Pinoçenë

E me Suharton vrasës të komunistëve me qindra
mija;

Po të tradhtuarit, të vrarët,
Kryet tek çojnë nga varrezat ku flenë,
Syve dot s'u besojnë
Se gjer ku mund të arrijë tradhtia.

12.

Ja,
Këto janë arsyet që na ndanë.
Këtu i ka themelët honi.
Jo,
Në një karrige
S'kish si të qëndronin bashkë,
Revizionizmi dhe Revolucioni.

13.

Tani se kush jeni bota ju njeh mirë,
Dhe këtë mirë po e shihni edhe ju;
Socialimperialistë kinezë,
Është vazhda e tradhtisë që ju solli gjer këtu.
E freskët,
E freskët vizita që «drugoviçëve» iu kthyet ju.
Si përpara altarit,
Kryeulur iu rrëfyet,
Kryeulur iu ratë në gju.

Për stalin tuaj revizionizmi jugosllav:
Perëndia mbi tokë, Buda, Papa,
Ju, famullitarë e arqipeshkvë,
Dhespotë e kardinalë, që i shkoni prapa.

Ai,
Për Bernshtajnin e Kautskin, Trockin e Brauderin,
— dishepulli dhe biri,

Ai, — dora
Që, në emër të tyre,
Në ditët tona,
Mbi komunizmin i pari shtiu.
Revizionizëm jugosllav do të thotë:
Frymëzues e pararendës i Kongresit të Njëzetë;
Revizionizëm jugosllav do të thotë:
Antikomunizmi vetë.
Qëndrimi ndaj tij — gur prove,
Vijë demarkacioni
Ku ndahen përjetësishi
Marksizëm-leninizmi nga revizionizmi, reaksiioni;
Ku ndahen përjetësish
Tradhtia klasore,
Nga diktatura e proletariatit, revolucioni.

14.

Hrushovianë e maoistë,
Revizionistë jugosllavë dhe eurokomunistë!
Ju gëzohi kur tufane në radhët e komunizmit
ngjasin

E deteve u ngajnjë në dallgë dhe acar,
Po nga stuhitë detet asgjë nuk humbasin,
Tunxhi e floriri veten provojnë në zjarr.
I pari, pleh e llomështirë, nga tallazet brigjeve
tretet,
Ndërsa i dyti përjetësisht i paprekur mbetet,
Ashtu siç mbeten edhe vetë detet, —
Dritë dhe llagar¹⁰⁾

15.

Tradhti e revizionizmit kinez!
Përpara revolucionit e proletariatit,
Si gjithë tradhtia klasore,
Në bankën e akuzës do t'përfundosh një ditë.
Po. Në bankën e akuzës:
Si renegate e socializmit, revolucionit, lirisë;
Atëherë nga këta brigje të kuq të Shqipërisë,
Si shumë proletarë nga kontinentet qark,
Edhe unë, si poet e komunist, do të vij nga larg
E aty, —
Ndërsa ty,
Gjunjët do të të dridhen përpara pretencës e
tërkuzës, —
Zërin do të ngre të akuzës
E, n'atë fund judësh e budësh «kauboj»,
N'atë përbysje dymbëdhjetëballësh tërmeti,
Epilogun këtyre vargjeve do t'u shtoj,
Epilogun këtij pamfleti.

10) Të filtruar e të pastër si qelibari

KREU I DHJETE

1.

Partin' flamur, të ardhmen ne ndërtojmë,
Nga thellësitë përbysim botn' e vjetër,
Këtu shqiponjat majash fluturojnë,
Këtu secili syrin në shënjestër.

Traktor' i parë rrugën nisi, shokë,
Makin' e parë shtigjeve tanë,
E mijëra metra sondat ndënë tokë,
Mbi ball' të tyre — marka «Shqipëri»!

Gëzojnë Korça, Shkodra, Myzeqeja
E ballin lart e kuqja Mallakastër,
Këndoijnë e ngrihen shqipet nga hareja
Për birin tënd, o lulja Gjirokastër!

«Largojuni! — armiqtë na thanë një ditë, —
«Se Fierzën vetë, kurre s'e ngrini dot!» —
Po PPSH-ja, diell e gjithë dritë,
Në ball' na priu e ne i dolëm zot.

Tani turbinat Drinit vërvhëllejnë
E yje drite ndizen rrëth e qark,
Po prap' mbi Drin ne diga do të ngremë
E digat rresht do zbresin varg e varg.

Parti e shtrenjtë, oxhakë në çdo anë,
Si maya malesh ngremë në çdo krah,
Veprat me kast q'armiqt' në mes na lanë,
Ne po i shpiem la edhe më la.

Endërrojnë ata të dalsh nga istikami
E duarshtrirë një ditë të të shikojnë,
Po ty në botë më fort të rritet nami,
Sepse shqiponjat qiejt gjithnjë sulmojnë.

Ndër shekuj, jo, ky popull asnjëherë
Zaptues të tjerve kurrë nuik u shkoi,
Po kush mendon mbi ne dorë të ngrerë,
Le ta provojë se sa do t'i kushtojë!

Ndaj, si ngaherë, çdo vit me dorë vetë,
Nga dy fidanë ullinjësh ne këtu rritim,
Një për shtëpinë, që vaj ajo të ketë,
Tjetrin që pushkën bukur ta vajitim.

2.

Katër klasikëve, etër t'komunizmit,
Parti, sa linde, besën ua dhe,
E asaj bese mal gjithmonë i mbete,
Se fjal' e dhënë e shenjtë është për ne.

Ndaj kur ti sot shpërthen mbi t'Budëve skotë
A mbi Kremlin rrufetë nuk i ndal,
Ata gazmorë gjëmojnë me zë të plotë:
— Qëlloji, moj, e grushti t'u bëftë mal! —

E përsëri kur fjala jote — shpatë
Mbi «specifikët» sulet të qëllojë,
Ata agimin shohin n'atë natë
E, «bjeri, bjeri!» thërrasin me një gojë.

E po ashtu kur zbraz ti mbi Marshetë,
A mbi Karriljot lumen dhe batak,
A Berlinguerët pleh edhe kënetë;
— Në vetull, moj, — gjëmojnë, — merru gjak! —

Dhe ti qëllon ashtu si ke qëlluar,
Dhe ti shpërthen ashtu si di ti vetë,
Misionit tënd ti kurrë s'i ke munguar,
Katër klasikët — flamuri yt në jetë.

Sot dhe partitë marksiste-leniniste
Radhët spastrojnë e ngjeshin si betoni,
Sulmojnë ato për t'ardhmen komuniste,
Trokët në botë ngado Revolucioni.

3.

Parti, Ti Dielli i së ndritshmes udhë,
Ti pos i malet, mal në çdo tufan,
Ti në ndërgjegje as edhe një rrudhë,
Ti si gjithnjë në t'Marksit istikam.

Sot lukuni, si kurrë e kurrë ndër mote,
Superfuqitë vërshojnë dhe buzëhoni,
Po uragan mbi to rreh fjala jote:
«Imperializmi dhe Revolucioni».

Shoku Enver, sa lartë Partinë e ngrite!
Ti udhëheqësi ynë në çdo shtrëngatë,
Atdheu mbarë t'uron: Mes rrezesh drite,
Sa malet, shok, nér mote, jetë të gjatë!

Eh, partizania, e zemrës kënga ime,
Sa herë për Të këndove gjer n'agim,
Ti pranë Tij në ditët plot gjëzime,
E sërisht pranë kur shkrep a vetëtin.

Parti-Enver, të sigurt dhe të qetë,
Drejt lartësish me Ju marshojmë ne,
Milionë miq mbi dhë na jatin fletë,
Internacional gjithë globi do të jetë,

Infernacionale,

Bota jonë e Re!

Gusht 1978 — qershori 1980

Qafézezi, L.

Internacionale, bota jonë e re. Poe-
më. (Red.: R. Vozga). T., «Naim Frashë-
ri», 1980.

52 f.

(B.m.) dhe
(B.v.) : 891.983-1

Q 16

Tirazhi 2000 kopje Formati 76x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1981